

NË EMER TË POPULLËT

P.nr:38/2017

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti për Krime të Rënda (në objektin e gjykatës-degës në Vushtrri), Kryetari i trupit gjykues Avni Mehmeti, anëtarët e trupit gjykues-gjyqtarët gjyqtarët Sabit Rama dhe Nuriye Shala, me procesmbajtësen Hasnije Muhaxheri, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDAKTUAR] i akuzuar për veprën penale; Keqpërdorim i të drejtës së votimit nga neni 216 par.1 pika 1.2 të KPK-ës, sipas akuzës se Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, PP.I.nr. 176/2015, dt.08.03.2017. Gjykata, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor, në prezencën e prokurorit të shtetit në PTH në Mitrovicë Njazi Rexha, të pandehurit Momqillo Nikoliq. Seanca e shqyrtimit gjyqësor, ka qenë publike, është udhëhequr në mënyrë verbale, ku njëdhja e shqyrtimit është regjistruar në procesverbal, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor me 25.10.2017, të-njëjtën ditë është shpallur publikisht aktgjykimi, ndërsa me dt.25.10.2017, është përpiluar me shkrim ky:

AKTGJYKIM

Kundër të akuzuarit:

[REDAKTUAR] me nofkën [REDAKTUAR] nga i ati [REDAKTUAR] e ëma [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR], i lindur me [REDAKTUAR] në fsh. [REDAKTUAR], me vendbanim në rrugën "[REDAKTUAR]" [REDAKTUAR], me nr. personal të identifikimit: [REDAKTUAR], serb, shtetas i Republikës së Kosovës teknik i xehetarisë, i martuar, din shkrim lexim, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, ndaj ti nuk zhvillohet ndonjë procedurë për vepër tjetër penale, për këtë rast është mbrojtur në liri.

Gjykata në mbështetje të nenit 363 par.1 nënpar.1.1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës(KPP-ës) ndaj të pandehurit [REDAKTUAR],

REFUZOHET AKUZA

SEPSE:

Me 8 qershor 2014 në shkollën fillore "Stana Baqanin" në fshatin Vrajev-Leposaviq në zgjedhjet nacionale për Kuvendin e Kosovës, në numrin e vendvotimit [REDAKTUAR] ka votuar një herë si votues me kusht, pastaj në qendrën e votimit në shtëpinë e kulturës në komunën e Leposaviqit, në numrin e vendvotimit [REDAKTUAR] në kundërshtim me nenin 91 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme ka votuar edhe një here si votues i rregullt.

-Me këtë kishte për të kryer veprën penale; Keqpërdorim i drejtës së votimit nga neni 216 par.1 pika 1.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

-Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë buxhetore të kësaj gjykate.

-Kërkesë pasurore-juridike nuk pati.

A r s y e t i m

Rrjedha e procedurës:

Prokuroria Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurit [REDAKTUAR] me dyshimin për veprën penale; Keqpërdorim i të drejtës së votimit nga neni 216 par.1 pika 1.2 të KPPK-ës.

Me 13 mars 2017, Prokuroria Themelore në Mitrovicë, aktakuzën PP-I.nr:176/2015 dt.08.03.2017, kundër të pandehurit [REDAKTUAR] e kishte dorëzuar në këtë Gjykatë.



Kompetenca e gjykatës:

Gjykata, pas pranimit të lëndës ka vërtetuar se në këtë çështje penale ka kompetencë lëndore dhe territoriale për ta shqyrtuar dhe për të vendosur në lidhje me këtë çështje. Gjykata, rikujton se kompetenca lëndore në këtë çështje penale rrjedhe nga fakti se vepra penale për të cilën është akuzuar i pandehuri: [REDAKTUAR] - Keqpërdorim i te drejtës së votimit nga neni 216 par.1 pika 1.2 të KPRK-së, përcaktohet se hyjë në kompetencë lëndore në departamentin e krimeve të rënda, sipas Ligjit për gjykatat dhe nenit 22 Kodit Procedurës Penale të Kosovës. Ndërsa, kompetenca territoriale për këtë Gjykatë, rrjedhe nga fakti se vepra penale për të cilën ishte ngarkuar i pandehuri: [REDAKTUAR] dyshohej se ishte kryer në territorin e komunës së Leposaviq të cilin e mbulon Gjykata Themelore në Mitrovicë.

Gjykata, gjen se në lidhje me këtë çështje penale, kundër të pandehuri: [REDAKTUAR] nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ishte ngritur kallëzimi penal i dt.30.03.2015.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, në këtë çështje penale ka mbajtur, gjithsejtë dy seanca të shqyrtimit gjyqësor. Seancat, janë mbajtur me dt.12.09.2017, dhe 25.10.2017. Seancat kanë qenë publike, janë regjistruar në procesverbal, janë mbajtur në prezencën e palëve; Prokurorit të Shtetit në PTH në Mitrovicë, Njazi Rexha, të pandehurit [REDAKTUAR]

Me 25 tetor 2017 në seancën e shqyrtimit gjyqësor, prokurori i shtetit në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë Njazi Rexha është tërhequr nga ndjekja penale si dhe e ka tërhequr akuzën PP-L.nr.176/2015, e dt.08.03.2017, ndaj të pandehurit [REDAKTUAR] për veprën penale: Keqpërdorim i te drejtës së votimit nga neni 216 par.1 pika 1.2 të KPRK-së, me arsyetimin se në bazë të raportit të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë në Prishtinë i datës:18.09.2017, me numër të referencës AKF/2017-2895/2017-2585, është konstatuar se nënshkrimi në listën e votuesve të rregullt nuk i është nënshkruar dhe nuk i përket të pandehurit [REDAKTUAR].

Gjykata, pasi ka pranuar njoftimin në seancë për tërheqjen nga ndjekja dhe akuzë PP-L.nr.176/2015, dt.08.03.2017, nga Prokuroria Themelore në Mitrovicë - prokurori i rastit Njazi Rexha ndaj të pandehurit [REDAKTUAR] kjo gjykatë vlerëson se, prokuroria si organ publik që benë ndjekjen penale, ka të drejtë ligjore në çdo kohë të tërhiqet nga ndjekja kjo deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor, andaj nga këto arsye, trupi gjykues konsideron se në mungesë të akuzës gjykimi nuk mund të vazhdojë, porse tërësi janë plotësuar kushtet ligjore për refuzimin e akuzës dhe nxjerrjen e aktgjykimit refuzues në mbështetje me nenin 363 par.1 nën par 1.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale, gjykata e maur komfor neneve 454 par.1. të KPP-ës. Nga të cekurat më lartë, e bazuar në nenin 363 par 1. nën par 1.1 të KPPK-së, u vendos si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti për Krime të Rënda

P.nr.38/2017, i dt.25.10.2017

Procesmbajtësja:
Hasnije Muhaxheri

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari:
Avni Mehmeu

KËSHILLË JURIDIKË: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjete) ditësh, prej ditës së pranimit të këtij aktgjykimi me shkrim, në kopje të mjaftueshëm për palët dhe gjykatën, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.